

RELACION
PËR PROJEKT-URDHRIN E KRYEMINISTRIT
“PËR NGRITJEN E TASK - FORCËS NDËRINSTITUCIONALE PËR
SEZONIN TURISTIK 2026”

I. QËLLIMI I PROJEKT-URDHRIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projekt-urdhri, që vjen si propozim i Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, është ngritja e Task - Forcës Ndërinstitucionale edhe për sezonin turistik 2026, e cila do të asistojë Komitetin për Menaxhimin e Sezonit Turistik (KMST) dhe është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave, miratimi i planit të masave për sezonin turistik 2026.

Në vijim të problematikave të hasura gjatë sezonit turistik veror 2025, lind e nevojshme që edhe për vitin 2026, të ndiqet e njëjta procedurë për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik.

Ngritja dhe funksionimi i Task – Forcës Ndërinstitucionale do të sigurojë një bashkëpunim institucional koherent me qëllim mbarëvajtjen e sezonit turistik duke menaxhuar fluksin e lartë të turistëve dhe shërbimet në këtë periudhë.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-URDHRIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projekt-urdhri është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-URDHRIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në kushtet e rritjes së vazhdueshme të fluksit turistik në vend dhe kompleksitetit në menaxhimin e tij, ngritja e Task-Forcës Ndërinstitucionale për sezonin turistik 2026 paraqitet si një instrument i domosdoshëm për garantimin e një qasjeje të koordinuar, proaktive dhe të integruar ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Bazuar në eksperiencën e sezonit turistik 2025 dhe në analizën e problematikave të evidentuara në terren, rezulton se sfidat kryesore lidhen me koordinimin ndërinstitucional, menaxhimin e flukseve të larta turistike, kontrollin e informalitetit, si dhe garantimin e standardeve të shërbimit dhe sigurisë.

Në këtë kuadër, përmes miratimit të planit të masave dhe funksionimit të Task-Forcës, synohet:

- **Forcimi i koordinimit ndërinstitucional**, përmes krijimit të një mekanizmi funksional dhe të përhershëm bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, duke mundësuar reagim të shpejtë dhe të sinkronizuar ndaj problematikave që lindin gjatë sezonit turistik;
- **Menaxhimi efektiv i fluksit turistik**, nëpërmjet planifikimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të lëvizjes në pikat kufitare, në infrastrukturën rrugore dhe në destinacionet kryesore turistike, me qëllim shmangien e mbingarkesave dhe garantimin e aksesit të sigurt;
- **Rritja e sigurisë dhe standardeve të shërbimit për turistët**, duke përfshirë forcimin e prezencës së strukturave të sigurisë publike, shërbimeve shëndetësore dhe mekanizmave të emergjencës, veçanërisht në zonat me intensitet të lartë turistik;
- **Përmirësimi i menaxhimit mjedisor dhe urban**, përmes garantimit të pastërtisë, kontrollit të mbetjeve, menaxhimit të zhurmave dhe respektimit të standardeve në zonat turistike, me fokus të veçantë në vijën bregdetare;
- **Formalizimi dhe rritja e kontrollit mbi aktivitetet turistike**, nëpërmjet intensifikimit të inspektimeve dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, me qëllim reduktimin e informalitetit dhe rritjen e konkurrencës së ndershme në treg;
- **Rritja e cilësisë së shërbimeve turistike**, duke siguruar përputhshmëri me standardet ligjore dhe teknike nga ana e strukturave akomoduese, stacioneve të plazhit, operatorëve të turizmit detar, subjekteve të transportit dhe shërbimeve të tjera mbështetëse;

Në mënyrë të veçantë, funksionimi i Task-Forcës si strukturë koordinuese në nivel të lartë institucional garanton ndjekjen sistematike të zbatimit të planit të masave, identifikimin në kohë të problematikave dhe ndërhyrjen e menjëhershme për zgjidhjen e tyre, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e përvojës turistike dhe imazhin e vendit tonë si destinacion i qëndrueshëm dhe cilësor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-urdhri është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar dhe të pikës 1, të nenit 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projekt-urdhër nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-URDHRIT:

Projekt-urdhri për ngritjen e Task-Forcës ndërinstitucionale të sezonit turistik parashikon si më poshtë:

Ngritja e Task-Forcës ka për synim asistimin që do t’i bëhet Komitetit për Menaxhimin e Sezonit Turistik 2026 (KMST) dhe njëkohësisht do të jetë përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin në afat të masave përgatitore të përcaktuara në planin e masave për sezonin turistik. Task-Forca do të asistohet nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe në përbërje do të ketë përfaqësues nga institucionet qendrore si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Prefekturat, agjenci dhe drejtori të përgjithshme në varësi të institucioneve të sipërpërmendura.

Task-Forca për sezonin turistik 2026 do të ketë disa detyra kryesore:

- të udhëzojë përgatitjen dhe të miratojë tërësinë e veprimtarive që do të kryejë çdo institucion/agjenci zbatuese, në zbatim të planit të masave për sezonin turistik;
- të bashkërendojë veprimtaritë ndërmjet institucioneve zbatuese. Të analizojë në vijimësi zbatimin e masave për çdo institucion;
- të propozojë, nëse është e nevojshme, nxjerrjen e akteve nënligjore, që i shërbejnë zbatimit të masave përgatitore, sipas planit të masave;

Të ngarkojë me detyra drejtuesit dhe strukturat zbatuese të drejtpërdrejta, të veprimtarive të planifikuara në planin e masave për sezonin turistik. Në lidhje

me organizmin e mbledhjeve, Task-Forca do të mblidhet çdo herë me njoftimin e kryetarit ose të personit të autorizuar prej tij dhe çdo përfaqësues do të raportojë mbi ecurinë e veprimtarive për institucionin/agjencinë zbatuese që përfaqëson. Ndërsa Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit do t'i raportojë Kryeministrit për rezultatet e arritura dhe për çështje të rëndësishme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E URDHRI

Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Task-Forca e Transportit Rrugor, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Agjencia Kombëtare e Turizmit, për zbatimin e këtij urdhri.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-URDHRI

Për hartimin e këtij projekt-urdhri kanë kontribuar Drejtoria e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit.

Plani i masave është dërguar për mendim pranë: Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Policisë së Shtetit, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Institucionet që kanë dhënë dakordësinë, duke konfirmuar draftin e planit të masave janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka konfirmuar planin e masave duke propozuar, që në masën *“Hartimi i planit të masave për oraret e kufizuara të lëvizjes së mjeteve në rrugët kombëtare gjatë sezonit turistik veror”* të jenë institucione bashkëpunuese *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Brendshme, pasi marrëveshja lidhet ndërmjet tyre.*

Ky propozim u mor në konsideratë dhe u reflektua në shtojcën e planit të masave.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit konfirmon planin e masave, duke propozuar si më poshtë:

- Ndjekjen e procesit të pastrimit të zonës bregdetare nga operatori ekonomik i kontraktuar për realizimin e këtij shërbimi, për periudhën 15 Qershor -15 Shtator 2026, për Bashkitë Shkodër, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë, Pogradec, Lezhë.
- Bashkëpunimin me njësitë vendore, prefekturat dhe institucionet kompetente për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit

të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar, në funksion të zbatimit të planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2026.

- Bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe vendosja në dispozicion të tyre e listës së subjekteve, të pajisur me kontratë për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, për sezonin turistik veror 2026, si dhe kontratat e plazhit, ekzistuese në fuqi, me afat disa vjeçar, nënshkruar në sezonin turistik veror 2025.
- Ushtrimin e kontrollit dhe inspektimit në të gjitha stacionet e plazhit në vijën bregdetare, për përmbushjen e kriterëve dhe standarteve në bazë të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, inspektimin e operatorëve të turizmit detar, sipas ligjit nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar”, i ndryshuar si dhe inspektimi i të gjitha veprimtarive turistike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” .
- Ndjekjen e procesit të aplikimeve për stacione sezonale ancorimi/bregëzimi, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022 “Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ancorimit/bregëzimit”, Urdhrit të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit nr. 280, datë 19.09.2022, nr. 6073/4 prot., “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të kërkesave për zhvillimin e veprimtarisë së stacioneve sezonale të ancorimit/bregëzimit”.
- Përgatitjen e kontratave për përdorimin e hapësirës së plazhit, për subjektet aplikues për sezonin turistik veror 2026, pas miratimit të tyre nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve, me palë përfituese Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
- Raportimin e menjëhershëm pranë strukturave të bashkisë/policisë për çdo ankesë të depozituar në AKB apo strukturat rajonale të saj lidhur me nivelin e zhurmave në zonën breguore për të siguruar një reagim të shpejtë dhe menaxhim efektiv të situatës, në funksion të garantimit të standarteve dhe qetësisë publike;
- Monitorimin e zonave që kanë prezencë të mbetjeve urbane të ngurta dhe mbetje të tjera me impakt negativ në mjedis, përgjatë akseve kombëtare dhe atyre që të çojnë në destinacionet turistike dhe raportimin pranë Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Njësitë

Vendore dhe Prefekturës përkatëse, si dhe monitorimi i mbetjeve në zonat turistike bregujore.

- Verifikimin e masave të sigurisë së pushuesve (rojet e plazhit, sipas kriterëve të përcaktuara, vendosja e sinjalistikës, bovat).
- Raportimin pranë institucioneve kompetente për të gjitha shkeljet që do të evidentohen në terren, përgjatë monitorimeve të përditshme, me qëllim marrjen e masave për parandalimin e tyre.
- Monitorimin e parcelave të përcaktuara si plazhe publike, kriterëve dhe standarteve në këto plazhe, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar.
- Realizimin e detyrave funksionale në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, të ndryshuar.

Propozimet e AKB u morën parasysh duke u shtuar në planin e masave.

Ministria e Punëve të Brendshme ka përcjellë planin e masave të hartuar nga Prefekturat e Qarqeve, nëpërmjet të cilit konstatohet se Prefektura e Qarkut Berat, Gjirokastër, Lezhë dhe Korçë kanë shprehur dakordësinë me planin aktual të masave kurse Prefekturat e Qarkut Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Tiranë, Vlorë kanë përcjellë planin e masave në nivel qarku, duke konfirmuar planin aktual të masave

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projekt-urdhrit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI
BLENDI GONXHIJA



PLANI I MASAVE PËR SEZONIN TURISTIK VEROR 2026

INSTITUCIONET	DETYRAT	INSTITUCIONE BASHKËPUNËSE
<p>Të realizojë takime me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në zonat bregdetare dhe liqenore për zbatimin e planit të masave për mbartëvajtjen e sezonit turistik veror 2026. Pjesëmarrje dhe bashkëpunim me Komitetet Rajonale të Turizmit, si detyrim institucional, bazuar në ligjin nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, nën drejtimin e prefekturave.</p> <p>Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve t'i vendoset në dispozicion, në fillim të sezonit turistik, lista e strukturave të certifikuara akomoduese dhe kontratave të lidhura për stacionet e plazhit.</p>	<p>Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>	<p>Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Ushtrimi i kontrollit dhe inspektimit në të gjitha stacionet e plazhit në vijën bregdetare, për përmirësimin e kritereve dhe standarteve në bazë të Vendimit të Ministrave nr. 649/2024 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", inspektimi i operatorëve të turizmit detar, sipas ligjit nr. 43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar", si dhe inspektimi i të gjitha veprimtarive turistike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit Nr. 93/2015 "Për Turizmin", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Ndëkja e procesit të aplikimeve për stacione sezonale ankorim/bregëzim, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022 "Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorim/bregëzimit", sipas Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 280, datë 19.09.2022, nr. 6073/4 prot., "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave për zhvillimin e veprimtarisë së stacioneve sezonale të ankorim/bregëzimit".</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Ndëkja e procesit të pastimit të zonës bregdetare nga operatori ekonomik i kontraktuar për realizimin e këtij shërbimi, për periudhën 15 Qershor -15 Shtator 2026, për Bashkitë Bashkitë Shkodër, Durrës, Kavajë, Rogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë, Pogradec, Lezhë</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Përgatitja e kontratave për përdorimin e hapësirës së plazhit, për subjektet aplikues për sezonin turistik veror 2026, pas miratimit të tyre nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve, me palë përfituese Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Bashkëpunimi me njësitë vendore, prefekturave dhe institucionet kompetente për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar, në funksion të zbatimit të planit të masave për mbartëvajtjen e sezonit turistik veror 2026.</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Raportimi i menjëhershëm pranë strukturave të bashkisë/policisë për çdo ankesë të depozituar në AKB apo strukturat rajonale të saj lidhur me nivelin e zhurmave në zonën bregënore për të siguruar një reagim të shpejtë dhe menaxhim efektiv të situatës, në funksion të garantimit të standarteve dhe qetesisë publike</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Bregdetit Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Sarandë</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Bregdetit Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Sarandë</p>

**MINISTRIA E
TURIZMIT
KULTURËS DHE
SPORTIT**

<p>Monitorimi i zonave që kanë prezencë të mbejtyeve urbane të ngurta dhe mbejtye të tjera me impakt negativ në mjedis, përgjatë aksëve kombëtare dhe ayre që të çojnë në destinacionet turistike dhe raportimin pranë Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Njësive Vendore dhe Prefekturës Përkatesë, si dhe monitorimi i mbejtyeve në zonat turistike breguore.</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Raportime pranë institucioneve kompetente për të gjitha shkeljet që do të evidencohen në terren, përgjatë monitorimeve të përditshme, me qëllim marrjen e masave për parandalimin e tyre</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Monitorimi i parcelave të përcaktuara si plazhe publike, kritereve dhe standardeve në këto plazhe, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar.</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Realizimi i detyrave funksionale në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, të ndryshuar.</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Verifikimi i masave të sigurisë së pushuesve (trojet e plazhit, sipas kritereve të përcaktuara, vendosja e sinjalizikës, boval)</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</p>
<p>Bashkëpunimi mes NIVV-ve dhe Agjencive Rajonale të Bregdetit Lezhë, Durres, Vlorë, Sarandë mbi vendqendrimet e mjeteve lundruese, bazuar në Vendimin nr. 60, datë 28.1.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar, ku përcaktohet ndër të tjera se: Për përcaktimin e vendqendrimëve dhe korridoreve të lëvizjes, njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare, strukturat e Policisë Kufitare, si dhe me Agjencitë Rajonale të Bregdetit.</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Bregdetit Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Njësiti e Pushimit Vendor Drejtoria e Përgjithshme Detare</p>
<p>Të publikohen të dhënat për strukturat akomoduese, agjencitë turistike dhe për subjekte të tjera turistike, në faqen zyrtare të MTKS-së sipas shpërndarjes gjeografike dhe destinacionit turistik.</p>	<p>Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore Agjencia Kombëtare e Turizmit Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit</p>
<p>Të planifikojë, orientojë, koordinojë Kalendarin Kombëtar të ngjarjeve kulturore të traditës sportive dhe natyrore që ofrojnë zëvajtje dhe kënaqësi për turistët në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe institucionet e saj, institucione të tjera qendrore dhe lokale, publike e private, shoqëria e organizata, etj. Të promovojë Kalendarin Kombëtar të Eveneve dhe aplikacionin TEA</p>	<p>Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Agjencia Kombëtare e Turizmit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>

	<p>Të sigurohet furnizim pa ndërprerje me energji elektrike, të merren masa të shuara për rregullimin në kohë sa më të shkurtrt të rast të ndërprerjeve të energjisë elektrike në zonat turistike.</p> <p>Perditesimi i listes së mjeteve turistike sipas shqodrësive të licencuara dhe pasqyrimi në faqen e Ministrisë.</p> <p>Perditesimi i informacionit mbi oraret dhe stacionet e autobusëve, për linjat ndërqytetase në të gjithë vendin dhe pasqyrimi i këtij informacioni në faqet publike të institucioneve.</p> <p>Zbatimi i parimeve të planifikimit të zhvillimit të turizmit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar, procedurën e cakimit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, përgatitjen dhe përmbajtjen e planit kombëtar sektorial të turizmit si dhe procedurën e hartimit të planit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit.</p> <p>Marja e masave për respektimin e kritereve në zbatim të ligjit me Nr.8308, datë 18.3.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar.</p> <p>Perditesimi i hartës së aksidenteve rrugore (hot spot), publikimi dhe vënia në dispozicion agjencive turistike.</p> <p>Të merren masa, për përuiminin e të dhënave në qdo kohë të mjeteve lundruese turistike, jahle, veljera etj.</p>	<p>Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike</p> <p>Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit</p> <p>Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit</p> <p>Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor</p> <p>Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme Detare Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p> <p>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Policia e Shtetit</p>
<p>MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL</p>	<p>Marja e masave për pasirimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesore kullues në zonat bregdetare nëpërmjet 4 Drejtorive Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, Fier, Durres dhe Korçë.</p> <p>Marja e masave për inspektimin e subjekteve që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë produkte ushqimore për garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit.</p> <p>Hartimi dhe zbatimi i një plani masash për garantimin e sigurisë publike në destinacionet turistike gjatë sezonit turistik veror 2026.</p> <p>Zbatimi i legjislatcionit që sanksionon krimin mjedisor si krim penal, me fokus të situar zonat turistike.</p>	<p>Policia e Shtetit</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Policia e Shtetit</p>
<p>MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME</p> <p>MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË</p> <p>MINISTRIA E MBROTJES</p>	<p>Të bashkërendohet puna për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, vizëzimet në rrugë dhe ndricimi i nevojshëm për të orientuar levizjen e sigurtë të turistëve nga terminali deri në dalje në bashkëpunim me Autoritetet Portuale dhe MIE.</p> <p>Të ushtrohen kontrole nëse mjedet e transportit të turistëve kanë lidhur kontratë me operatorin/agjencinë turistike, emri i së ciles dubet të jetë i ekspozuar dukshëm.</p> <p>Saktësimi i numrave të emergjencës për pushuesit duke shtuar postat e policisë/ personelit në zonat e frekuentuara gjatë sezonit turistik.</p> <p>Krijimi i lehtësive të hyrje – daljeve në Pikat Kombëtare të Kufirit për grupet e turistëve.</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Policia e Shtetit</p>
<p>MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME</p>	<p>Promovimi i Shqipërisë nëpërmjet rrjetit të përfaqësive diplomatike.</p>	<p>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit</p> <p>Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Prefektura Njësitë e Veteqeverisjes Vendore</p>
	<p>Angazhimi i FARSH, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile gjatë sezonit turistik.</p>	

MINISTRIA E MBROJTJES

Nenskrimi i martesjes së bashkëpunimit mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për ishullin e Sazanit në funksion të vizitave turistike.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes

Monitorimi dhe trajtimi i mbetjeve nga zonat turistike drejt vendeve të depozitimit të paracaktuara, në ishullin e Sazanit

Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit

Të risë prezencën në territor dhe efikasitetin e shërbimit ambulator, të urgjencës mjekësore në të gjitha destinacionet turistike me fluks të vizitorëve.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Inspektoriat Shëtitësor

Të bëhen inspektime dhe kontrole për respektimin e normave dhe rregullave higjieno - sanitare në objektet turistike, restorante e struktura akomoduese, subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm, pishinat, subjektet e shërbimit ambulator të hapura në të gjitha destinacionet turistike, subjektet social kulturore dhe sportive

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Inspektoriat Shëtitësor

Të bëhet Vlerësimi Mikrobiologjik I Ujërave Bregdetare të Larjes dhe të tritit numri i stacioneve të monitorimit. Identifikimi I burimeve direkte dhe indirekte të ndotjes së pazheve. Të publikohen rezultatet.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Inspektoriat Shëtitësor

Kryerja e inspektimeve përgjatë gjithë vijës bregdetare në:
• Subjektet të cilat janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ndërmarrjeve të UK;
• Subjektet që I derdhin ujërat e zeza në gropa sepike, për evidentimin e kontratave me subjekte shtetërore ose private (bote).

Inspektoriat Shëtitësor

Organizimi i shërbimit shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror. (identifikimi i strukturave që do të shërbejnë si qendra shëndetësore verore, vendosja e sinjalistikës, paisja e tyre me paisje e nevojshme.

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor sipas një liste të përcaktuar shërbimesh për qytetarët që paraqiten pranë këtyre qendrave.

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

Trajtimi i stafëve mjekësore që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror.

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

Garantimi e shërbimit falas nga urgjencia mjekësore në kohën e duhur për shtetasit që konsiderohen në gjendje rezikshme të lartë për jetën, sipas protokolleve të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

Ofrimi i shërbimit të urgjencës mjekësore në të gjitha nivelet e tij, për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj me banim të përhershëm ose të përkohshëm në Shqipëri, si dhe për çdo shtetas të huaj që është duke kaluar në territorin e Shqipërisë.

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

Barazi në përfutimin e shërbimit të urgjencës mjekësore pa asnjë diskriminim; ndërthurja e veprimeve të urgjencës mjekësore me të gjitha emegjencat kombëtare (zjarrfikës, polici).

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

Venia në gatishmëri e qendrës së shërbimit të helikopterëve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për asistencën mjekësore dhe transportin e rasteve urgjente.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Deziniektimi i zonave bregdetare, ligatinore dhe qytetëve bregdetare, përpara fillimit të sezonit veror. (MSHMS) Kontributi në fushatat dhe aksionet e pasuritit të zonave turistike.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Prefektura
Njësitë e Vetëqeniesjes Vendore

Të ndihmojë për sa është e mundur dhe të monitorojë grumbullimin dhe largimin e mbetjeve nga zonat turistike drejt vendeve të depozitimit të paracaktuara, duke koordinuar me Njësitë e Vetëqeniesjes Vendore për monitorimin e shërbimit të pasuritit, largimit të mbetjeve dhe monitorimit të pasuritë së stacioneve të plazhit, në zonat bregdetare dhe brigjet e liqentit.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Agjencia Kombëtare e Bregdetit
Njësitë e Vetëqeniesjes Vendore
Agjencia Kombëtare e Turizmit
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
Prefekturat

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

<p>MINISTRIA E MËDIJISIT</p>	<p>AKZM/ADZM synojnë realizimin e objektivave për sezonin turistik 2025 si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konservimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore në territorin e zonave të mbrojtura, ku ekosistemet do të ofrojnë shërbimet e tyre për vizitorët; • Venien në rolin e guidës së stafit të zonave të mbrojtura në shtigjet e markuara; • Funksionimin e gendrave ekzistues të informacionit të mëposhtëm, përmes bashkërendimit të punës me pushtetin vendor. Menaxhimi i vizitorëve në qdo stinë të viti dhe ofrimi i informacionit të nevojshëm përmes hartave, fletëpalosjeve, etj.; • Informim dhe promovim nëpërmjet faqes web AKZM.gov.al • Rritja e sigurisë për turistë në zonat e mbrojtura; • Marrje masash për të bërë të mundur gënjallimin dhe largimin e mbejeve nga zonat e mbrojtura 	<p>Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura</p>
	<p>Të hartohen dhe zbatohen planet për evidentimin dhe menaxhimin e mbejeve urbane të ngurta dhe mbeje të tjera me impakt negativ në mjedis, përgjatë akseve kombëtare dhe atyre që të pojnë në destinacionet turistike.</p>	<p>Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit përmes Agjencisë Kombëtare të Bregdetit Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë edhe nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>
	<p>Të kontrollohen shkaktimet e ujërave të përdorura në zonat e pushimit dhe të plazheve.</p>	<p>Agjencia Kombëtare e Mjedisit</p>
	<p>Të hartohen dhe miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, planet lokale të zhumrave. Të zbatohet programi i kontrollit, për mafjet për nivelin e zhumrës në destinacionet turistike nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit dhe struktura përgjegjëse në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Agjencia Kombëtare e Mjedisit Prefektura Policia e Shtetit</p>
	<p>Kontrolli i subjekteve tregtare në destinacionet turistike për ekspozimin e çmimeve për produktet/shërbimet e ofruara, në vende të dukshme për publikun.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Taimëve</p>
	<p>Kontrolli i subjekteve tregtare për zbatimin e procedurës së fiskalizimit.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Taimëve</p>
	<p>Kontrolli i subjekteve tregtare në destinacionet turistike për lëshimin e taturës taitimore dhe me vlerë reale.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Taimëve</p>
<p>MINISTRIA E FINANCAVE</p>	<p>Aksioni I informaltetit mbi deklarinin e punonjësve dhe pagës reale, mbi bazë risku.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Taimëve</p>
	<p>Verifikimi I subjekteve tregtare që operojnë nëpërmjet platformave online për shumën e deklarameve dhe minimizimin e subjekteve të paregjistruara</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Taimëve</p>
	<p>Bashkërendimi me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin me korrektesi të nenit 49 të Ligjit nr. 92/2014 "Për Tairimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Taimëve Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit</p>
	<p>Ushtrimin e kontrollit në subjekte që ushtrijnë aktivitet gjatë sezonit turistik, me synim minimizimin e punës informale, punës jashtë rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, funksionimit të marrëdhënieve të punës në drejtim të kohëzgjatjes së punës, punës së kryer në turmin e dytë dhe të tretë, në ditët e pushimit javor, festave, etj.</p>	<p>Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore</p>
	<p>Në fokus të veçantë të këtyre inspektimeve është punësimi i punëmarrësve nën 18 vjeç, i të huajve dhe vryluesve të plazhit në stacionet e plazhit, në lidhje me punësimin e tyre.</p>	<p>Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore</p>
	<p>Kontrolli për dokumentacionin e subjekteve që kanë në përdorim hapësirat publike në plazhe, kontrata e përdorimit të stacionit të plazhit nga bashkia përkatëse dhe nëse kanë përmblusur detyrimin ligjor të regjistrimit të tyre në organet taitimore.</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Taimëve</p>
	<p>Zhvillimi i stacioneve të plazhit publik me standarde dhe kushtet higjieno - sanitare sipas destinacioneve dhe tipologjive.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>
	<p>Sigurimi i singularitetit së nevojshme në plazhe (tërë dhe ujë) për saktësimin e plazheve të menaxhuara dhe publike, si dhe për zonat ujore të lejuara dhe ato me rezikshmi.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>

	<p>Të merren masa për mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme (vijëzimi i rrugëve, vendosja e sinjalistikës dhe informacioni në lidhje me shërbimet bazë: polici, spitale, plazhe, pila të vizitueshme), rrugëve që çojnë drejt destinacioneve turistike dhe ndriçimin e tyre.</p> <p>Të zbatohen planet për menaxhimin e mbetjeve urbane, shtimi i kontinierëve dhe hartimin e planeve të qarta, me fasha orari të përshtatshme për largimin e mbetjeve urbane në të gjithë destinacionet turistike.</p> <p>Të përcaktojnë vendparkimet e autonjeteve në zonat e plazhëve.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p> <p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p> <p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit Prefektura</p>
<p>NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE</p>	<p>Të hapen dhe të vihen në funksion të plotë zyrat e informimit për turistët në qendrat e qyteteve dhe në afërsi të pikave turistike.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>
	<p>Të vihen në dispozicion të pushuesve numra telefoni pranë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për ankesat apo shërbimet e munguara ndaj tyre.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>
	<p>Të merren masa për furnizimin pa ndërprerje me ujë si dhe sisteminin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave e bardha dhe të zeza, veçanërisht në destinacionet turistike. Të përgatiteti plani i koordinimit për ta patur nën kontrolli situatën për çdo defekt të mundshëm gjatë sezonit turistik.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>
	<p>Hartimi i kalendarit të Festave Lokale 2026 nga çdo bashki. Organizimi dhe mbartëja e tyre si mundësi e mirë për provimin e atraksioneve turistike të zonës si edhe prodhimeve tradicionale dhe karakteristike të zonës.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>
	<p>Të hartojë një plan të qartë të depozitimit të mbetjeve nga subjektet turistike, me orare dhe vende të përcaktuara, të monitorojë grumbullimin e mbetjeve deri në largimin e tyre drejt vend - depozitimeve të përcaktuara.</p>	<p>Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p>
	<p>Të merren masa për menaxhimin e qenve endacakë në zonat turistike, nëpërmjet sterilizimit, strehimit, akomodimit dhe mirëmbajtjes së tyre, me qëllim garantimin e sigurisë dhe kushteve higjieno-sanitare gjatë sezonit turistik</p> <p>Koordinimi ndërinstitucional përmes Komiteteve Rajonale të Turizmit, të institucioneve lokale për mbartëvajtjen e sezonit turistik</p> <p>Koordinim ndërinstitucional me Prefekturat, mbi monitorimin e pasirimeve frekvente në zonat turistike, organizimin e aksioneve për pastrim të territoreve në zonave turistike, para dhe gjatë sezonit turistik veror.</p>	<p>Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura</p> <p>Prefekturat Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore</p> <p>Prefekturat Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore</p>
<p>PREFEKTURAT</p>	<p>Në kuadër të menaxhimit dhe mbartëvajtjes së sezonit turistik veror, Prefektet e Qarqeve me urdhër ngrajtë Task-Forcën, e cila do të ngjëjë zbatimin e masave në nivel qarku dhe raportojnë në Ministrinë e Brendshme mbi zbatimin e deyrave dhe masave të institucioneve pjesë të Task-Forcës dhe Njësitë të Vetëqeverisjes që ka secila prefekturë nën juridiksionin e saj.</p>	<p>Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Ministria e Punëve të Brendshme Prefekturat</p>
	<p>Të merren masa për verifikimin dhe kontrollin paraprak të mjeteve që kryejnë transport turistik ujor, me qëllim ndalimin e qarkullimit të mjeteve të pa licensuara nga MTKS, duke kryer kontrollat përpara nisjes së udhëtimit dhe duke shmagur kontrollat gjatë itinerarit të udhëtimit.</p>	<p>Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Ministria e Punëve të Brendshme Prefekturat</p>